



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	01/12/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Abdulsatar IBRAHIMI Drejtor i Departamentit të Prokurimit në KOSTT sh.a
CC:	z. Naim BEJTULLAHU Kryeshf Ekzekutiv në KOSTT sh.a
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: "Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH"

I nderuar z. IBRAHIMI

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH" me numër prokurimi: KOSTT-13-84/12-511, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin, kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me tenderin "Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH" me nr. prokurimi: KOSTT-14-84/12-511 në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

KOSTT, bazuar në nevojën e Instalimit të grupeve matëse në mes KOSTT/KEK/OSH ka paraparë procedurë të hapur Prokurimi me titull: “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH” Aktivitet të cilin, KOSTT nuk ka mund ta finalizoj që nga viti 2012.

Kronologjia e aktivitetit të prokurimit për Instalimin e Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH sipas KRPP-së është si në vijim: Njoftim për Kontratë (09/11/2012); Njoftim për Kontratë (05/02/2013) – Vazhdim Afati; Njoftim Anulimi (13/03/2013); Njoftim për Kontratë (16/09/2013); Njoftim për Kontratë (23/10/2013) – Vazhdim Afati; Njoftim Anulimi (19/12/2013); Njoftim për Kontratë (14/01/2014) – Ri Tenderim; Njoftim për Kontratë (19/02/2014) – Vazhdim Afati; **Njoftim për Kontratë (26/02/2014)** – Vazhdim Afati; Njoftim për Kontratë (24/03/2014) – Vazhdim Afati; Njoftim Anulimi (27/03/2014); **Njoftim për Kontratë (03/04/2014)** – Ri Tenderim; Njoftim për Dhënie të Kontratës (10/06/2014); Anulim i Dhënies së Kontratës (01/09/2014); Njoftim për Dhënie të Kontratës (23/09/2014)

KOSTT, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Dosja e Tenderit” me titull: “*Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH*” me numër prokurimi: KOSTT-14-84/12-511 më datë 03/04/2014. KOSTT edhe në aktivitetin e fundit ka përsëritur të njëjtat kërkesa të cilat AKK i kishte konsideruar si shkelje në Opinionin paraprak, drejtuar Autoritetit Kontraktues.

Në aktivitetin e fundit në Dosjen e Tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Kërkesat e Përshtatshmërisë Profesionale, pika 7.1 nën-pika 3, kërkohet: Kopja e pasqyrave financiare të audituara për 3 vitet e fundit (2010,2011 dhe 2012) dhe raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse. Tre vitet e fundit janë 2011, 2012, 2013 e jo siç janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues 2010, 2011, 2012. Autoriteti Kontraktues, bazuar në Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik është dashur të precizoj që pasqyrat e Auditimit të jenë të audituara nga kompani e licencuar a auditimit me reputacion, e jo vetëm nga auditori. Më tej, në pikën 7.1 Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që: Të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmitë e kërkuara dokumentare. Kopja e Pasqyrave Financiare të Audituar, si kriter, i takon rubrikës Kërkesat mbi Gjendjen Ekonomike dhe Financiare, dhe si e tillë çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues për Përshtatshmërinë Profesionale; Gjendja Ekonomike dhe Financiare, si dhe Aftësitë Teknike dhe/ose Profesionale do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga Autoriteti Kontraktues, Agjencia Kundër Korrupsion ka konstatuar se ky aktivitet prokurimi nuk është paraparë nga Autoriteti Kontraktues në Planifikimin e Prokurimit gjatë tre viteve të fundit (2012,2013,2014)

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), pika 9.1, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkohet: Origjina e transformatorëve matës duhet të jetë nga Kompani-prodhues të cilat kanë furnizuar së paku nga 1000 transformatorë matës të nivelit 10kv e ma lartë në

vendet e BE, DUKE MOS LLOGARITUR VENDIIN E VET nga viti 2010 e deri me tani (duhet të prezantohet me dokument). Autoriteti Kontraktues ka paracaktuar dhe kufizuar origjinën e produktit, me paracaktimin e vendit të origjinës për produktet furnizuese, Autoriteti Kontraktues favorizon Operator të caktuar Ekonomik dhe në të njëjtën kohë diskriminon të tjerët. Autoriteti mund ti referohet një standardi vendor ose ndërkombëtar (siç edhe i është referuar në Dosje të Tenderit, Certifikatat ISO për produktet që liferohen NJEHSOR, TRANSFORMATOR MATES, KABILLO ELEKTRIKE DHE MBROJTJE RELE) për furnizim me produkte, por assesi të kufizohet nga vende të caktuara. Bazuar në legjislacionin e vendit dhe ligjeve në fuqi, një gjë e tillë nuk është e lejuar dhe nuk i jep hapësirë konkurrencës së lirë dhe legale. Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët “ose e barasvlershme”.

Autoriteti Kontraktues KOSTT, në Raportin e Vlerësimit të përgatitur më datë **06/05/2014**, të nënshkruar nga Komisioni Vlerësues më datë 06/06/2014 dhe nga Zyrtari i Prokurimit më datë 09/06/2014, kishte konstatuar se të gjithë Operatorët Ekonomik ofertues, janë **TË PËRGJEGJSHËM**. Në këtë Raport, në Deklaratën komisionit thuhet: *Komisioni Vlerësues pas vlerësimit të tenderëve deklaroi se OE që kanë dorëzuar ofertë janë të përgjegjshëm dhe propozon dhënien e kontratës OE “Caraglio SRL” dhe NTSH “ELECTRA”, i cili është i përgjegjshëm dhe ka ofruar çmimin më të ulët*

Më **09/06/2014** Autoriteti Kontraktues ka bërë “Njoftim për Dhënie të Kontratës” dhe shpërblen me Kontratë OE “Caraglio SRL” dhe NTSH “ELECTRA”. Operatori tjetër ofertues “NP MONTEN” dhe “G3 INGINERING” të pa kënaqur me Njoftimin për Dhënien e Kontratës, më datë 20/06/2014 kanë paraqitur ANKESË në Organin Shqyrtues të Prokurimit – OSHP, me të cilën ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkeljen e neneve 51, 56, 59, 60 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr-04 /L042. Në përmbajtjen e Ankesës, tek pika 7, Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet, nën-pika 6 Kërkesat Teknike (Technical Data Sheet) thuhet: “OE në Technical Data Sheet për pajisjet AMR Tower Workstations (DELL Precision T7610) PC Notebooks for Metering (DELL Precision M4800) janë plotësuar vetëm me YES, (në Informatat sqaruese të Dosje së Tenderit thuhet se ofertuesi që i plotëson me YES ose OK do të diskualifikohet” Në fakt, në “Informata Shtesë” të KOSTT të datës 24/04/2014, nr 3, thuhet: “Ju informojmë se të gjitha tabelat me të dhënat teknike “Technical Data Sheet” duhet të plotësohen nga ana OE me të dhënat teknike të pajisjeve që ofrojnë. Çdo konfirmim tjetër me fjalë p.sh. OK ose YES në këto tabela nuk do të pranohet si të vlefshme dhe oferta e tyre mund të s’kualifikohet” Në të njëjtin dokument, në të njëjtën pikë, në versionin e gjuhës angleze, thuhet: “We are informing you that the all Technical Data Sheet have to be filled by EO with all necessary technical data for the new equipments. Otherwise all other written confirmation as is OK or YES in these table is unacceptable and will be automatically disqualificate”. Në versionin e gjuhës angleze, ka kuptimin që do të diskualifikohet automatikisht, por në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka paraparë që: “Në rast se ka mospërputhje në mes versioneve gjuhësore, versioni i gjuhës Shqipe të mbizotëron”. Pra, Operatori

Ekonomik ankues “NP MONTEN” dhe “G3 INGINERING” i ka orientuar dëshmitë në drejtim të justifikimit të Ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit – OSHP.

Raporti i Ekspertit Shqyrtues (22/07/2014), Mendimi i Eksperti Shqyrtues: *“Eksperti shqyrtues – teknik, duke u bazuar në konstatimet e cekura në raport mendon që Autoriteti Kontraktues – Operatori Sistemi Transmisioni dhe Tregu Sh.A (KOSTT), lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin mes të KOSTT/KEK/OSSH, me Nr. të Prokurimit KOSTT/14/84/12/511, në përgjithësi nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së Nr. 04/L-042, prandaj rekomandon që të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe njëkohësisht rekomandon që të aprovohet ankesa e OE ankues, si e bazuar dhe propozon që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në ri vlerësim”* Më datë 25/07/2014 Autoriteti Kontraktues, reagon në lidhje me Raportin e Ekspertin Shqyrtues me të cilin reagim shprehë qëndrimin e Autoriteti Kontraktues duke thënë se: ***“Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit në fjalë mendon se ka vepruar plotësisht drejtë duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një ofertë e cila ka një dallim në çmim prej 420.000,00 euro apo diku rreth 22% të vlerës së kontratës”***

Organi Shqyrtues i Prokurimit nuk e merr për bazë reagimin e Autoriteti Kontraktues, e as dallimin në çmim, mes Operatorit më të lirë dhe Operatorit Ankues, dhe më datë 04/08/2014 merr vendim (PSH Nr.205/14) për Ri Vlerësimin e Ofertave dhe OE “ELECTRA” e konsideron si të pa përgjegjshëm.

Më pas, më datë 06/08/2014 OE “ELECTRA” ofron sqarim për Autoritetin Kontraktues dhe për Organin Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me mospajtimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së. Pas kësaj, më datë 11/08/2014 ofrohet Konkluzion nga OSHP (P.sh.nr.205/14), me të cilin hidhet poshtë shqyrtimi i ankesës së OE “ELECTRA”, e datës 06/08/2014.

Autoriteti Kontraktues – KOSTT më 29/08/2014 ka bërë ri vlerësimin e ofertave, sipas vendimit të OSHP-së, dhe sipas një procesverbali që posedon Agjencia Kundër Korrupsion, me numër protokollit 554 i datës 29/08/2014 thuhet: *Komisioni Teknik Profesional në përbërje të plotë, pas shqyrtimit të hollësishëm të secilës ofertë teknike veç e veç të ofertuar nga të gjithë Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në këtë Projekt (Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH), dhe në përputhje me aktvendimin e KSHE-së të datës 18/08/2014 unanimitisht dhe njëzëri jep këtë vlerësim: Nga Kontrollimi, analizimi dhe vlerësimi i hollësishëm i të gjitha Ofertave Teknike të të gjithë Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në projektin “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH”, konkludon njëzëri se: ***Të gjithë Operatorët Ekonomik (1. “Caraglio SRL&ELECTRA”; 2. “Monten & 3G Engineering”; 3. “CG & Comtel”; 4. “Konçar & Monting”), janë të përgjegjshëm dhe i plotësojnë kërkesat teknike në përputhje me kërkesat që burojnë nga Autoriteti Kontraktues.***

Komisioni i njëjtë i Ri vlerësimit (në bazë të aktvendimit të KSHE-së të datës 18/08/2014) më datë 05/09/2014 ka përgatitur një procesverbal tjetër të Ri Vlerësimit totalisht i kundër me atë të një jave më parë. Në këtë procesverbal thuhet: ***Të gjithë Operatorët Ekonomik (1. “Caraglio SRL&ELECTRA”; 2. “Monten & 3G Engineering”; 3. “CG & Comtel”; 4. “Konçar &**

Monting”), janë të PA-përgjegjshëm dhe se nuk i plotësojnë kërkesat teknike dhe Procedurale në përputhje me kërkesat që burojnë nga Autoriteti Kontraktues. Bazuar në procesverbalin e datës 05/09/2014, Autoriteti Kontraktues në Raportin e Ri vlerësimit të datës 08/09/2014 ka deklaruar: Komisioni vlerësues pas vlerësimit të tenderëve deklaroi se OE që kanë dorëzuar ofertë janë të papërgjegjshëm teknikisht dhe rekomandon anulimin e aktivitetit të Prokurimit.

Me këtë konstatim të Komisionit Vlerësues, D0rejtori i Prokurimit z. Abdylsatar IBRAHIMI nuk është pajtuar dhe më datë 22/09/2014 ka vendosur në kundërshtim me rekomandimin e Komisionit Vlerësues dhe Operatorin Ekonomik “Caraglio & Electra” e ka shpallë të pa përgjegjshëm dhe ta shpërblej me kontratë Operatorin Ekonomik “Monten & 3G Engineering”.

Agjencia Kundër Korrupsion, gjatë vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të fakteve të mbledhura për këtë aktivitet prokurimi, ka konstatuar si më poshtë.

Agjencia Kundër Korrupsion ka konstatuar se Operatori Ekonomik Fitues “MONTEN”, për tenderin “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH” nuk ka ofertuar me ofertë të përgjegjshme, ngase në Dosjen e Dorëzuar i mungojnë Dëshmitë për punë të ngjashme të realizuara nga viti 2010. Sipas Dosjes së Tenderit, dëshmi do të konsiderohen vetëm KONTRATAT me CERTIFIKATË përfundimtare të pranimit të punëve të nënshkruara me operator të distribucionit ose prodhuesit e energjisë, në të cilat janë të përfshira implementimi dhe komisionimi i: Njehsorëve, transformatorëve matës dhe mbrojtje rele. (Dëshmitë do të vërtetohen nga AK). Operatori Ekonomik “MONTEN” fitues, ka paraqitur një “Certifikata e pranimit të punëve” e lëshuar nga KEK, Divizioni i Rrjetit, me numër protokollit 8939, e datës 17/12/2012, e cila është e lëshuar për tenderin “Zgjerimi dhe Përforsimi i Rrjetit Distributiv në KEK 2010” për Konzorciumin NTSH “MONTING” dhe “NMIQ Montcommerce” sh.p.k, pra nuk ka të bëjë me Operatorin Ekonomik i cili ka fituar kontratën për tenderin “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH”. Po ashtu, Operatori Ekonomik fitues, ka sjellë edhe disa raporte të përfundimit të punëve.

Raporti i Organit mbikëqyrës për punët e kryera sipas situacionit të parë në furnizimin dhe montimin e pjesëve elektrike për mirëmbajtjen e Ndriçimit publik, pjesa II-të të pjesës lindore të qytetit të Prishtinës. Ky dokument nuk ka vulë dhe nuk është i protokolluar, por vetëm i nënshkruar nga mbikëqyrësit.

Raporti i Komisionit Profesional i Pranim Teknik, i lëshuar nga KEK, me datë 15/07/2014, ndërsa është i protokolluar nga KEDS, me numër protokollit: 3041, më datë 1/08/2013 dhe ky raport përmban emrin e Projekt Menaxherit, emër i cili, është person i njëjtë me Ekspertin Teknik Shqyrtues që e ka caktuar OSHP, për shqyrtimin e Ankesës së Operatorit Ekonomik fitues të këtij tenderi.

Referencë nga KEDS, për anëtarin e dytë të Konzorciumit të Grupit të Operatorit Ekonomik fitues, e cila ka numër protokollit: 7702 të datës 07/11/2013, për projektin “Supply and Installation of Multifunctional Protection at 110 kV & 35 kV SS for KEK” me të cilin dëshmon se cili ka qenë

projekt menaxher për kontratën e lartë cekur. Po ashtu edhe ky dokument është lëshuar nga Projekt Menaxheri, emër i cili, është person i njëjtë me Ekspertin Teknik Shqyrtues që e ka caktuar OSHP, për shqyrtimin e Ankesës së Operatorit Ekonomik fitues të këtij tenderi.

Referencë nga KEDS, për anëtarin e dytë të Konzorciumit të Grupit të Operatorit Ekonomik fitues, e cila ka numër protokollit: 7703 të datës 07/11/2013, për projektin “Supply and Installation of Multifunctional Protection at 110 kV & 35 kV SS for KEK” me të cilin dëshmon se anëtari i dytë i grupit të Operatorit Ekonomik fitues për tenderin: “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH”, ka qenë bashkë kontraktues për tenderin në fjalë. Po ashtu edhe ky dokument është lëshuar nga Projekt Menaxheri, emër i cili, është person i njëjtë me Ekspertin Teknik Shqyrtues që e ka caktuar OSHP, për shqyrtimin e Ankesës së Operatorit Ekonomik fitues të këtij tenderi.

Operatorët Ekonomik është dashur të caktojnë Projekt Menaxherin për të ofertuar në këtë tenderin: “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH”. Operatori Ekonomik Fitues, ka caktuar Menaxher të projektit i cili sipas Dosjes së tenderit është dashur të ofroj dëshmi për projekte të ngjashme nga viti 2009, dëshmi të cilat Operatori Ekonomik Fitues, nuk i ka ofruar sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit, por vetëm ka ofruar shkresë “INFORMATË” ku operatori Ekonomik Fitues jep emrat e tre personave fizik, dhe kontaktet e tyre për të vërtetuar saktësinë e CV-së së projekt menaxherit të caktuar.

Raporti i Komisionit Profesional i Pranim Teknik, i lëshuar nga KOSTT, me numër protokollit: 746, më datë 03/10/2013 dhe ky raport përmban vërejtjet e Komisionit Profesional dhe në tabelë tek “Statusi aktual” është vendosur fjalia “ e pa kryer”, ndërsa nën tabelë thuhet: “Punë kryesi i ka eliminuar të gjitha vërejtjet e bëra nga komisioni profesional për pranimin teknik të Trafo Fushës 3 në NS Ferizaj 1 Bibaj”. Njëri nga shtatë komisionarët nuk e ka nënshkruar raportin. Është i habitshëm fakti, se në të njëjtin raport paraqiten vërejtje në tabelë, dhe menjëherë, në raportin e njëjtë thuhet se: “Punë kryesi i ka eliminuar të gjitha vërejtjet e bëra nga komisioni profesional për pranimin teknik të Trafo Fushës 3 në NS Ferizaj 1 Bibaj”

Raporti i Komisionit Profesional i Pranim Teknik, i lëshuar nga KEDS, me numër protokollit: 3353, më datë 14/08/2013 dhe ky raport përmban të dhëna për projektin “Ndërtimi i NN-110/10(20) kV-Prishtina –VII. Me të cilin dëshmon se anëtari i dytë i grupit të Operatorit Ekonomik fitues për tenderin: “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH”, ka qenë bashkë kontraktues për tenderin në fjalë. Po ashtu edhe në këtë dokument anëtar i komisionit është personi me emër të njëjtë me Ekspertin Teknik Shqyrtues që e ka caktuar OSHP, për shqyrtimin e Ankesës së Operatorit Ekonomik fitues të këtij tenderi.

Raport: Eliminimi i Vërejtjeve, të evidentuara nga komisioni i kaluar i pranimit teknik të TS-it 110/x/x(kV) Palaj, i lëshuar nga KEDS, me nr.Prot:4943 të datës 17/09/2013, me të cilin raport Kryetari i Komisionit e njofton Menaxheren e Projektit se janë eliminuar vërejtjet e evidentuara nga komisioni i pranimit teknik nr.4304 i datës 28/05/2012. Janë eliminuar vërejtjet thuajse pas gjashtëmbëdhjetë muajve

Raport nga Komisioni i pranimit teknik, i lëshuar nga KEK me numër protokolli: 6575 të datës 20/12/2010 me të cilin raport dëshmohet se njëri nga anëtarët e grupit të Operatorëve Ekonomik fitues të tenderit “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH” ka qenë i kontraktuar në projektin “Instalimi i kthinave të reja 20kV, në TS 35/10(20) kV Shtime”

Në ofertën e Operatorëve Ekonomik fitues për tenderin “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH”, Në ANNEX 4.2 – Technical Data Sheet for CTs and VTs , faqe 2/90 pika 2. “VOLTAGE TRANSFORMERS (VT’s)”, nën pika 2.19 Accuracy Class, widening I (Metering – MAIN Meter) është kërkuar (Required) cl.0.2 ndërsa tek ofertomi (Offered by Bidder) nuk është ofruar asnjë shifër (rubrika është e zbrazët).

Në ofertën e Operatorëve Ekonomik fitues për tenderin “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH”, Në ANNEX 4.3 – Technical Data Sheet for Surge Arresters 35 kV and 10 kV, faqe 1/14 pika 1. “SURGE ARRESTERS 10(20)kV”, nën pika 1.12 “Countinuous operating voltage (Uc) maximum residual voltage (8/20) tek pajisja 5 kA, nuk është ofruar asnjë shifër. Autoriteti Kontraktues në tabelën e sajë i ka zhvendosur për një rresht më poshtë vlerat e kërkuara. P.sh. Tek pika 1. “SURGE ARRESTERS 10(20)kV”, nën pika 1.12 “Countinuous operating voltage (Uc) maximum residual voltage (8/20) tek pajisja 5 kA, nuk është kërkuar asnjë vlerë, deri sa duhet të jetë ≤ 30.8 ; për 10 kA është kërkuar ≤ 30.8 , duhet të kërkohej ≤ 32.8 ; për 20 kA është kërkuar ≤ 32.8 , duhet të kërkohej ≤ 36.2 . Grupi i Operatorëve Ekonomik fitues, ka ofruar vlerat e gabuara ashtu si janë paraqitur në tabelën e Autoriteti Kontraktues KOSTT. Tek kërkesa dhe Oferta i ka paraqitur vlerat e njëjta. Për 5 kA nuk kërkohej fare në tabelë, nuk ka ofruar fare në tabelë; për 10 kA kërkohej ≤ 30.8 , e ka ofertuar në tabelë ≤ 30.8 ; për 20kA kërkohej ≤ 32.8 , e ka ofruar në tabelë ≤ 32.8 . Të gjitha këto vlera të paraqitura në tabelë, Grupi i Operatorëve Ekonomik fitues i ka paraqitur sa për të plotësuar kriterin e plotësimit. Në katalogun e prodhuesit “TRIDELTA Parafoudres S.A” me të cilin ka ofertuar Grupi i Operatorëve Ekonomik fitues në tabelën e sajë ofrohen vlera jo të njëjta me ato që i kanë plotësuar operatorët. Standardi i prodhuesit “TRIDELTA Parafoudres S.A” është sipas tabelës së më poshtme:

Type	HE12	HE36
5 kA 8/20	30.8	91.7
10 kA 8/20	32.8	97.5
20 kA 8/20	36.2	107.5

Agjencia Kundër Korrupsion iu është drejtuar Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike pran Universitetit të Prishtinës për interpretim profesional në lidhje me disa pozicione që janë ofertuar nga Operatorët Ekonomik. Agjencia ka kërkuar nëse ofertat me të dhënat përkatëse janë më të favorshme sesa kërkesa e Autoritetit Kontraktues, ose jo. Në kërkesën e Agjencisë Kundër Korrupsion me numër protokolli 01-3645/14 janë kërkuar informata për pajisje për instalime të grupeve matëse, por sipas FIEK, këto pajisje bëjnë pjesë në grupin e pajisjeve mbrojtëse. Sipas Raportit të FIEK me numër protokolli 4072/14 është dhënë përgjigje për interpretimin profesional. Sipas Raportit të FIEK: Shkarkuesit e mbitensionit të cilët kanë kohë të reagimit më të shkurtë janë

zgjidhje më e mirë teknike se të njëjtit me kohë të reagimit më të gjatë, andaj shkarkuesit e mbitensionit me kohë reagimi 9.6 μ s, **paraqesin zgjidhje teknike më të mirë.**

Në pikën tjetër të interpretimit është kërkuar informatë për: Continuous Operating Voltage (U_c) max residual voltage 8/20 (Tensioni Operativ i vazhdueshëm (U_c) tensionit max 8/20) ms, por duhet të jetë: Maximum Residual Voltage 8/20 Current Wave (kV)-(Tensioni maksimal residual (kV) për valën e rrymës 8/20 (μ s/ μ s)). Në vazhdim, të raportit thuhet se Vlerat e tensionit maksimal residual (kV) për valën e rrymës 8/20 (μ s/ μ s) për shkarkuesit e mbitensionit të prodhueseve të ndryshëm kanë vlera të ndryshme.

Për rastitn hipotetik pajisja mbrojtëse (shkarkuesi i mbitensionit) për vlerë të tensionit maksimal residual prej 30.8 kV, për rrymë nominale 10 kA (rrymës goditëse) të formës 8/20 (μ s/ μ s) është zgjidhje më e mirë teknike se ajo me vlerë të tensionit 35 kV.

Për rastitn hipotetik pajisja mbrojtëse (shkarkuesi i mbitensionit) për vlerë të tensionit maksimal residual prej 32.8 kV, për rrymë nominale 20 kA (rrymës goditëse) të formës 8/20 (μ s/ μ s) është zgjidhje më e mirë teknike se ajo me vlerë të tensionit 38.9 kV.

Për rastitn hipotetik pajisja mbrojtëse (shkarkuesi i mbitensionit) për vlerë të tensionit maksimal residual prej 40 kV, për rrymë nominale 40 kA (rrymës goditëse) të formës 8/20 (μ s/ μ s) është zgjidhje më e mirë teknike se ajo me vlerë të tensionit 40.8 kV.

Prodhuesit botëror të shkarkuesve të mbitensioneve me vlera të caktuara të rrymës goditëse (10 kA, 20 kA, 40 kA) japin vlera të ndryshme të përafërta për Tensioni Maksimal Residual (kV) për valën e rrymës 8/20 (μ s/ μ s).

Agjencia Kundër Korrupsion pas shqyrtimit dhe analizimit të fakteve të gjetura në këtë proces, si dhe pas konsultimeve profesionale të bëra në lidhje me tenderin “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH” me nr. prokurimi: KOSTT-14-84/12-511, konstaton se të gjitha mospërputhjet eventuale që janë pjesë e dosjes së tenderit, nuk kanë ndonjë domethënie dhe nuk kishin ndikuar në funksionalizimin e Instalimit të grupeve matëse. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues herën e parë me të drejtë ka rekomanduar Operatorin Ekonomik më të lirë për kontratë, pasi që mund të mos e dëmtonte buxhetin me mbi **400.000 €**.

Dëmtimi i buxhetit me këtë shumë, bie përgjegjësi e Autoriteteve Përgjegjëse

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi; **Nenin 8** Planifikimi i Prokurimit; **Nenin 27** Dosja e Tenderit; **Nenin 6** Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; **Nenin 71** Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; pika 18 Specifikimi Teknik nga Udhëzuesi Operativ i prokurimit Publik si dhe **Neni 5** Gjendja Ekonomike dhe Financiare i Udhëzimit Administrativ 02/2014

Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për operatorët ose operatorët ekonomik potencial.

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se praktika të tilla nuk duhet lejuar, andaj rekomandon anulimin e këtij aktiviteti, duke mos i përsëritur praktikat e ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!